

**Rekomandimi CM/Rec(2010)12
i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare
për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë**

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010
në mbledhjen e 1098-të të Deputetëve të Ministrave)*

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke pasur parasysh nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (këtej e tutje referuar si "Konventa", 5 ETS nr. 5), i cili parashihet se "çdokush ka të drejtë për një proces gjyqësor të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj", dhe për ligjin relevant të rastit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

Duke pasur parasysh Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në nëntor të vitit 1985;

Duke pasur parasysh opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE-KKGJE), në punën e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (KEED) dhe në Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve të përgatitura në kuadër të takimeve shumëpalëshe të Këshillit të Evropës;

Duke vënë në dukje se, në ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore, roli i gjykatësve është thelbësor në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke dëshiruar të promovohet pavarësia e gjykatësve, që është një element i qenësishëm i sundimit të ligjit, dhe e domosdoshme për paanshmërinë e gjyqtarëve dhe për funksionimin e sistemit gjyqësor;

Duke pasur parasysh se pavarësia e gjyqësorit i siguron çdo personi të drejtën për një gjykim të drejtë dhe për këtë arsye nuk është privilegj për gjyqtarët, por një garanci për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke i mundësuar çdo personi që të ketë besim në sistemin e drejtësisë;

Të vetëdijshëm për nevojën për të garantuar pozitën dhe kompetencat e gjyqtarëve në mënyrë që të arrihet një sistem ligjor efikas dhe i drejtë dhe që të inkurajohen që të angazhohen në mënyrë aktive për funksionimin e sistemit gjyqësor;

Të vetëdijshëm për nevojën për të siguruar ushtrimin e duhur të përgjegjësisë, detyrave dhe kompetencave gjyqësore që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të të gjithë personave;

Duke dëshiruar që të merren mësim nga përvojat e ndryshme në shtetet anëtare sa i përket organizimit të institucioneve gjyqësore në përputhje me rendin dhe ligjin;

Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e sistemeve ligjore, pozitave kushtetuese dhe qasjet e ndarjes së pushteteve;

Duke vënë në pah se asgjë në këtë rekomandim nuk ka për qëllim zvogëlimin e garancive të pavarësisë dhënë gjyqtarëve nga kushtetutat apo sistemet ligjore të shteteve anëtare;

Duke vënë në dukje se kushtetutat apo sistemet ligjore të disa shteteve anëtare kanë themeluar një këshill të tillë, që në këtë rekomandim do referohen si "Këshilli Gjyqësor";

Duke dëshiruar që të promovohen marrëdhëniet midis autoriteteve gjyqësore dhe gjyqtarëve individuale të shteteve të ndryshme anëtare, në mënyrë që të nxisë zhvillimin e një kulture të përbashkët gjyqësor;

Duke pasur parasysh se Rekomandimi Rec(94)12 i Komitetit të Ministrave mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve duhet të azhurnohet në thelb në mënyrë që të fuqizohen të gjitha masat e nevojshme për të promovuar pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqtarëve, që të garantohet dhe të jetë më efektive përgjegjësia e tyre dhe të forcohet roli i gjykatësve individualë dhe i gjyqësorit në përgjithësi.

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare të marrin masa për të siguruar që dispozitat e përfshira në shtojcën e këtij rekomandimi, i cili e zëvendëson Rekomandimin e sipër-përmendur Rec(94)12, të aplikohen në legjislacionin, politikën dhe praktikën e tyre dhe se gjyqtarët mundë të kryejnë funksionet e tyre në përputhje me këto dispozita.

Shtojca e Rekomandimit CM/Rec(2010)12

Kapitulli I – Aspektet e përgjithshme

Fushëveprimi i rekomandimit

1. Ky rekomandim është i aplikueshëm për të gjithë personat që ushtrojnë funksione gjyqësore, duke përfshirë edhe ata që kanë të bëjnë me çështjet kushtetuese.
2. Dispozitat e përcaktuara në këtë rekomandim aplikohen edhe për gjyqtarët jo-profesionistë, përveç kur është e qartë nga konteksti që ato të aplikohen vetëm për gjyqtarët profesionistë.

Pavarësia e gjyqësorit dhe niveli në të cilin ajo duhet të ruhet

3. Qëllimi i pavarësisë, siç përcaktohet me nenin 6 të Konventës, është për t'i garantuar çdo personi të drejtën themelore për një gjykim të drejtë të rastit të tij/saj, vetëm në baza ligjore dhe pa ndonjë ndikim të papërshtatshëm.
4. Pavarësia e gjyqtarëve individuale është e garantuar me pavarësinë e gjyqësorit në tërësi. Si e tillë, ajo është një aspekt themelor i sundimit të ligjit.
5. Gjyqtarët duhet të kenë liri të papenguar për të vendosur për se rastet në mënyrë të paanshme, në përputhje me ligjin dhe interpretimin e tyre të fakteve.
6. Gjyqtarët duhet të kenë kompetenca të mjaftueshme dhe të jenë në gjendje t'i ushtrojnë ato në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre dhe të ruajnë autoritetin e tyre dhe dinjitetin e gjykatës. Të gjithë personat e ndërlidhur me rastin e caktuar, duke përfshirë edhe organet publike ose përfaqësuesit e tyre, duhet t'i nënshtrohen autoritetit të gjyqtarit.
7. Pavarësia e gjyqtarit dhe e gjyqësorit duhet të përfshihen në Kushtetutë ose në nivelin më të lartë të mundshëm ligjor në shtetet anëtare, me më shumë rregulla specifike të parashikuara në nivel legjislativ.
8. Kur gjyqtarët konsiderojnë se pavarësia e tyre është kërcënuar, ata duhet të jenë në gjendje t'i drejtohen një këshilli gjyqësor ose një autoriteti tjetër të pavarur, ose duhet të kenë mjete efektive për sanimin e gjendjes.
9. Një rast nuk duhet të tërhiqet prej një gjykatësi të caktuar pa arsye të bazuara. Vendimi për të tërhequr një rast nga një gjykatës duhet të merret në bazë të kriterëve objektive, të para-caktuara dhe duke ndjekur një procedurë transparente nga një autoritet brenda gjyqësorit.
10. Vetëm vetë gjykatësit duhet të vendosin për kompetencën e tyre në raste individuale të përcaktuara me ligj.

Kapitulli II – Pavarësia e jashtme

11. Pavarësia e jashtme e gjyqtarëve nuk është prerogativë apo privilegj i dhënë në interes të vetë gjyqtarëve, por në interes të sundimit të ligjit dhe të personave që kërkojnë dhe presin drejtësi të paanshme. Pavarësia e gjyqtarëve duhet të konsiderohet si një garanci e lirisë, respektim i të drejtave të njeriut dhe zbatim i paanshëm i ligjit. Paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarëve janë thelbësore për të garantuar barazinë e palëve në gjykata.
12. Pa cenuar pavarësinë e tyre, gjyqtarët dhe gjyqësori duhet të mbajnë marrëdhënie konstruktive pune me institucionet dhe autoritetet publike të përfshirë në menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, si dhe me profesionistë detyrat e të cilëve janë të lidhura me punën e gjyqtarëve në mënyrë që të ndihmojnë administrimin efektiv dhe efikas të drejtësisë.
13. Duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve.
14. Ligji duhet të parashikojë sanksione ndaj personave që kërkojnë të ndikojnë tek gjyqtarët në mënyrë të gabuar.
15. Vendimet duhet të arsyetohen dhe të shpallen publikisht. Gjyqtarët nuk duhet të jenë të detyruar në mënyra tjera të justifikojnë arsyet e vendimeve të tyre.
16. Vendimet e gjyqtarëve nuk duhet t'i nënshtrohen ndonjë rishikimi tjetër përveç apelimit pas rihapjes së procedurës, siç është paraparë me ligj.
17. Me përjashtim të vendimeve për amnisti, falje apo masave të ngjashme, autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv nuk duhet të marrë vendime të cilat shfuqizojnë vendimet gjyqësore.
18. Nëse autoriteti ekzekutiv dhe legjislativ komenton vendimet e gjyqtarëve, duhet të shmangen kritikata që do të pengonin pavarësinë ose besimin e publikut në gjyqësor. Gjithashtu duhet të shmangen veprime që mund ta vënë në pikëpyetje gatishmërinë e tyre që të veprojnë në përputhje me vendimet e gjyqtarëve, përpos duke deklaruar qëllimin e tyre për ta kundërshtuar.
19. Procedurat dhe çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë janë me interes publik. Megjithatë, e drejta për informim në lidhje me çështjet gjyqësore duhet të ushtrohet duke pasur parasysh kufizimet e imponuara nga pavarësia e gjyqësorit. Zëdhënësit e gjykatave ose themelimi i shërbimeve të shtypit dhe të komunikimit janë në përgjegjësinë e gjykatave ose nën këshillat gjyqësorë apo nën autoritete të tjera të pavarura është i inkurajuar. Gjyqtarët duhet të jenë të përmblajtur në marrëdhëniet e tyre me mediat.
20. Gjyqtarët, të cilët janë pjesë e shoqërisë ku ata shërbejnë, nuk mund të administrojnë në mënyrë efektive drejtësinë pa pasur besimin publik. Ata duhet të informohen lidhur me pritjet që shoqëria ka për sistemin gjyqësor dhe për ankesat rreth funksionimit të tij. Mekanizmat e përhershme për të marrë mendime të tilla të themeluar nga këshillat gjyqësorë apo autoritete të tjera të pavarura do të kontribuonin për këtë.
21. Gjyqtarët mund të angazhohen në aktivitete jashtë funksioneve të tyre zyrtare. Për të shmangur konflikte të vërteta apo të perceptuara të interesit, pjesëmarrja e tyre duhet të kufizohet në veprimtari në përputhje me paanshinë dhe pavarësinë e tyre.

Kapitulli III – Pavarësia e brendshme

22. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit nënkupton pavarësinë e secilit gjyqtar individual në ushtrimin e funksioneve të gjykimin. Gjatë marrjes së vendimit gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm dhe në gjendje të veprojnë pa asnjë kufizim, ndikim të pavend, presion, kërcënim apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, nga çdo autoritet, duke përfshirë edhe autoritetet e brendshme të gjyqësorit. Organizimi hierarkik gjyqësor nuk duhet të dëmtoj pavarësinë individuale.

23. Gjykatat Superior nuk duhet t'u japin udhëzime gjyqtarëve lidhur me mënyrën se si duhet të vendosin në raste individuale, me përjashtim të vendimeve paraprake ose kur të vendoset për mjete juridike sipas ligjit.

24. Shpërndarja e rasteve brenda një gjykate duhet të bëhet sipas kritereve objektive të paracaktuara në mënyrë që të mbrohet e drejta për një gjykatës të pavarur dhe të paanshëm. Shpërndarja nuk duhet të ndikohet nga dëshirat e një pale në rast apo të çfarëdo pale tjetër të interesuar ndryshe për rezultatin e rastit.

25. Gjyqtarët duhet të jenë të lirë të formojnë dhe të anëtarësohen në organizata profesionale objektivat e të cilave janë që të ruajnë pavarësinë e tyre, të mbrojnë interesat e tyre dhe të promovojnë sundimin e ligjit.

Kapitulli IV – Këshillat Gjyqësorë

26. Këshillat gjyqësorë janë organe të pavarura, të krijuara me ligj ose në bazë të kushtetutës, që kërkojnë të ruajnë pavarësinë e gjyqësorit dhe të gjyqtarëve individuale dhe në këtë mënyrë për të promovojnë funksionimin efikas të sistemit gjyqësor.

27. Jo më pak se gjysma e anëtarëve të këshillave të tilla duhet të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre nga të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe duke respektuar pluralizmin brenda gjyqësorit.

28. Këshillat gjyqësorë duhet të demonstrojnë shkallën më të lartë të transparencës ndaj gjyqtarëve dhe shoqërisë duke zhvilluar procedura të paracaktuara dhe vendime të arsyetuara.

29. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, këshillat gjyqësorë nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e gjykatësve individualë.

Kapitulli V – Pavarësia, efikasiteti dhe burimet

30. Efikasiteti i gjyqtarëve dhe i sistemeve gjyqësore është një kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të çdo personi, në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës, sigurisë juridike dhe të besimit publik në sundimin e ligjit.

31. Efikasiteti është dhënia e vendimeve cilësore brenda një kohe të arsyeshme pasi çështja është trajtuar me konsideratë të drejtë. Gjyqtarët individualë janë të obliguar që të sigurojnë menaxhim efikas të rasteve për të cilat ata janë përgjegjës, duke përfshirë zbatimin e vendimeve ekzekutimi i të cilave bie nën juridiksionin e tyre.

32. Autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor janë të obliguar që të sigurojnë për gjyqtarët kushte për të përmbushur misionin e tyre dhe duhet jenë efikas duke mbrojtur dhe respektuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve.

Burimet

33. Secili shtet duhet të ndajë burime, objekte dhe pajisje adekuate në gjykata për t'u mundësuar atyre që të funksionojnë në përputhshmëri me standardet e përcaktuara në nenin 6 të Konventës dhe për t'u mundësuar gjyqtarëve që të punojnë në mënyrë efikase.

34. Gjyqtarët duhet të pajisen me informacionin që ata e kërkojnë për të pasur mundësi që të marrin vendimet procedurale përkatëse ku vendimet e tilla kanë implikime financiare. Autoriteti i një gjyqtari për të marrë një vendim në një rast të veçantë nuk duhet të kufizohet vetëm me një kërkesë për të shfrytëzuar burimet në mënyrë më efikase.

35. Gjykatave duhet t'i caktohen një numër i mjaftueshëm i gjyqtarëve dhe personelit mbështetës të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme.

36. Për të parandaluar dhe për të zvogëluar ngarkesën e punës së tepërt në gjykata, duhet të merren masa në përputhje me pavarësinë e gjyqësorit për t'u caktuar personave të tjerë të kualifikuar detyrat jo-gjyqësore.

37. Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të rasteve në mënyrë elektronike dhe teknologjive të komunikimit dhe informimit duhet të promovohet nga autoritetet dhe gjyqtarët, dhe përdorimi i përgjithshëm i tyre në gjykata duhet të inkurajohet në mënyrë të ngjashme.

38. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e gjyqtarëve. Këto masa mund të përfshijnë mbrojtjen e gjykatave dhe të gjyqtarëve të cilët mund të bëhen, ose janë viktime të, kërcënimeve apo akteve të dhunës.

Zgjidhja alternative e kontesteve

39. Duhet të promovohen mekanizmat e zgjidhjes alternative të kontesteve.

Administrimi i Gjykatave

40. Këshillat gjyqësorë, nëse ekzistojnë, apo autoritete të tjera të pavarura përgjegjëse për administrimin e gjykatave, vetë gjykatat dhe/ose organizatat profesionale të gjyqtarëve mund të konsultohen kur është duke u përgatitur buxheti i sistemit gjyqësor.

41. Gjyqtarët duhet të inkurajohen që të përfshihen në administratën e gjykatave.

Vlerësimet

42. Me synimin për të kontribuar në efikasitetin e administrimit të drejtësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së tij, shtetet anëtare mund të përdorin sisteme për vlerësimin e gjyqtarëve nga autoritetet gjyqësore, në përputhje me paragrafin 58.

Dimensioni ndërkombëtar

43. Shtetet duhet t'u sigurojnë gjykatave mjete të përshtatshme për t'iu mundësuar gjyqtarëve që të përmbushin funksionet e tyre në mënyrë efikase në rastet kur përfshihen elemente të huaj apo ndërkombëtare dhe për të mbështetur bashkëpunimin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare mes gjyqtarëve.

kapitulli VI – Statusi i gjyqtarit

Përzgjedhja dhe karriera

44. Vendimet në lidhje me përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të bazohen në kritere objektive të paracaktuara me ligj ose nga autoritetet kompetente. Vendimet e tilla duhet të bazohen në merita, duke pasur parasysh kualifikimet, aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për të gjykuar rastet duke zbatuar ligjin dhe duke respektuar dinjitetin njerëzor.

45. Nuk duhet të ketë diskriminim ndaj gjyqtarëve ose kandidatëve për zyrë gjyqësore mbi baza të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik apo tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, shoqërimi me pakicë kombëtare, prona, aftësi të kufizuara, orientimi seksual apo ndonjë status tjetër. Kërkesa që një gjyqtar ose një kandidat për post gjyqësor duhet të jetë shtetas i shtetit në fjalë nuk duhet të konsiderohen diskriminuese.

46. Autoriteti që merr vendime për zgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të jetë i pavarur nga kompetencat ekzekutive dhe legjislative. Me synimin për të garantuar pavarësinë e tij, të paktën gjysma e anëtarëve të autoritetit duhet të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre.

47. Megjithatë, kur parashihet me dispozitat ligjore kushtetuese apo të tjera që kreu i shtetit, qeveria apo pushteti legjislativ të marrë vendime në lidhje me përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve, atëherë duhet të autorizohet një autoritet i pavarur dhe kompetent me një pjesë të konsiderueshme të marrë nga gjyqësori (pa paragjykuar rregullat e zbatueshme për këshillat Gjyqësorë të përfshira në Kapitullin IV) për të bërë rekomandime apo të shprehin mendime të cilat autoriteti përkatës i emërimit i përcjellë në praktikë.

48. Anëtarësimi i autoriteteve të pavarura të përmendura në paragrafët 46 dhe 47 duhet të sigurojë përfaqësimin më të gjerë të mundshëm. Procedurat e tyre duhet të jenë transparente dhe aplikuesve duhet ofruar arsyet lidhur me vendimet nëse kërkohen. Një kandidat i pasuksesshëm duhet të ketë të drejtën për të kundërshtuar vendimin, ose të paktën procedurën sipas së cilës është marrë vendimi.

Mandati i përhershëm dhe pandërrueshmëria

49. Siguria e mandatit të përhershëm dhe pandërrueshmëria janë elementet kryesore të pavarësisë së gjyqtarëve. Rrjedhimisht, gjyqtarët duhet të kenë mandat të garantuar deri në një moshë të obliguar të pensionimit, aty ku ekziston.

50. Kushtet e detyrave të gjyqtarëve duhet të rregullohen me ligj. Emërimi i përhershëm duhet të ndërpritet vetëm në rastet e shkeljeve të rënda të dispozitave disiplinore ose penale të përcaktuara me ligj, ose kur gjyqtari nuk mundet më të kryejë funksione gjyqësore. Pensionimi i parakohshëm duhet të jetë i mundur vetëm me kërkesë të gjyqtarit në fjalë apo për arsye shëndetësore.

51. Nëse rekrutimi është bërë për një periudhë provuese apo për afat të caktuar, vendimi për të konfirmuar apo ribërë emërimin e tillë duhet të merret vetëm në përputhje me paragrafin 44 për të siguruar që pavarësia e gjyqësorit është respektuar plotësisht.

52. Gjyqtari nuk duhet të emërohet në një post të ri ose të zhvendoset në një zyrë tjetër gjyqësore pa dhënë pëlqimin për këtë, përveç në rastet e sanksioneve disiplinore apo reformimit të organizimit të sistemit gjyqësor.

Kompensimi

53. Rregullat kryesore të sistemit të kompensimit për gjyqtarët profesionistë duhet të përcaktohen me ligj.

54. Kompensimi i gjyqtarëve duhet të jetë konform profesionit dhe përgjegjësisë të tyre, dhe të jetë e mjaftueshme t'i mbrojtur ata nga nxitjet që synojnë të influencojnë vendimet e tyre. Duhet të ketë garanci që në rast të sëmundjes apo pushimit prindëror do të ketë kompensim të arsyeshëm, si dhe për pagesë të pensionit, e cila duhet të jetë në proporcion të arsyeshëm me nivelin e tyre të kompensimit gjatë punës. Duhet të parashihen dispozita të veçanta ligjore si masë mbrojtëse kundër reduktimit të kompensimit me synim specifikisht ndaj gjyqtarëve.

55. Duhet të shmangen sistemet që kompensimin e gjyqtarëve e bëjnë në bazë të performancës së tyre meqë kjo mund të krijojë vështirësi për pavarësinë e gjykatësve.

Trajnimet

56. Gjyqtarëve duhet ofruar trajnime teorike dhe praktike fillestare dhe gjatë shërbimit të tyre, të financuar tërësisht nga shteti. Kjo duhet të përfshijë çështjet ekonomike, sociale dhe kulturore që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Intensiteti dhe kohëzgjatja e trajnimeve të tilla duhet të përcaktohet në bazë të përvojës së mëparshme profesionale.

57. Një autoritet i pavarur, në përputhje të plotë me autonominë arsimore, duhet të sigurojë që programet e trajnimeve fillestare dhe gjatë shërbimit i plotësojnë kërkesat e çiltërsisë, kompetencës dhe paanësisë që janë të qenësishme në pozita gjyqësore.

Vlerësimet

58. Nëse autoritetet gjyqësore krijojnë sisteme për vlerësimin e gjyqtarëve, sistemet e tilla duhet të bazohen në kritere objektive. Këto duhet të publikohen nga autoriteti kompetent gjyqësor. Procedura duhet t'u mundësojë gjyqtarëve për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi aktivitetet e tyre dhe në vlerësimin e këtyre aktiviteteve, si dhe për të kundërshtuar vlerësimet para një autoriteti të pavarur ose një gjykatë.

Kapitulli VII – Detyrat dhe përgjegjësitë

Detyrat

59. Gjyqtarët duhet të mbrojnë të drejtat dhe liritë e të gjithë personave në mënyrë të barabartë, duke respektuar dinjitetin e tyre në kryerjen e procedurave gjyqësore.
60. Gjyqtarët duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në të gjitha rastet, duke siguruar një seancë të drejtë për të gjitha palët dhe, kur është e nevojshme, shpjegojnë çështjet procedurale. Gjyqtarët duhet të veprojnë dhe të shihet që veprojnë pa ndonjë ndikim të papërshtatshëm të jashtëm në procedurë gjyqësore.
61. Gjyqtarët duhet të gjykojnë rastet të cilat i janë referuar atyre. Ata duhet të tërhiqen nga një lëndë ose të refuzojnë të veprojnë kur ka arsye të vlefshme të përcaktuara me ligj, dhe jo ndryshe.
62. Gjyqtarët duhet të menaxhojnë secilën lëndë me kujdesin e duhur dhe brenda një kohe të arsyeshme.
63. Gjyqtarët duhet të japin arsye të qarta për gjykimet e tyre në gjuhën që është e qartë dhe e kuptueshme.
64. Gjyqtarët, në raste të përshtatshme, duhet të inkurajojnë palët që të arrijnë marrëveshje miqësore.
65. Gjyqtarët duhet rregullisht të përditësojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre.

Përgjegjësitë dhe procedurat disiplinore

66. Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve apo peshimi i provave nga gjyqtarët për të përcaktuar rastet nuk duhet të jenë shkas i krijimit të përgjegjësisë civile ose disiplinore, përveç në raste keqdashëse dhe neglizhence të madhe.
67. Vetëm shteti mund të kërkojë të vendosë përgjegjësinë civile të një gjyqtari me anë të veprimit të gjykatës në rast se i duhet dhënë kompensim.
68. Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve apo peshimi i provave nga gjyqtarët për të përcaktuar rastet nuk duhet të jenë shkas i krijimit të përgjegjësisë penale, përveç në raste keqdashëse.
69. Nëse gjykatësit dështojnë të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe të duhur mund të pasojnë procedura disiplinore. Procedura të tilla duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose një gjykatë me të gjitha garancitë për një gjykim të drejtë dhe gjyqtarit duhet dhënë e drejta për të kundërshtuar vendimin dhe sanksionin. Sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale.
70. Gjyqtarët nuk duhet të merren personalisht përgjegjës, nëse vendimi i tyre anulohet ose ndryshohet përmes ankesës.
71. Kur nuk janë duke ushtruar funksione gjyqësore gjyqtarët janë përgjegjës në bazë të të drejtës civile, penale dhe administrative në të njëjtën mënyrë si çdo qytetar tjetër.

Kapitulli VIII – Etika e gjyqtarëve

72. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre gjyqtarët duhet të udhëhiqen me parime etike të sjelljes profesionale. Këto parime përfshijnë jo vetëm detyrat që mund të sanksionohen me masa disiplinore, por edhe ofrojnë udhëzime për gjyqtarët se si të sillen.
73. Këto parime duhet të parashihen në kodet e etikës gjyqësore të cilat duhet të frymëzojnë besimin e publikut tek gjyqtarë dhe gjyqësorin. Gjyqtarët duhet të luajë një rol kryesor në zhvillimin e kodeve të tilla
74. Gjyqtarët duhet të kenë mundësi të kërkojnë këshilla mbi etikën nga një trup brenda gjyqësorit.